

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I LETRAVE ME VLERË

Raport Vjetor 1998
Raport Vjetor 1998

NGJARJE KRYESORE

NE 16 SHTATOR 1998, KOMISIONI I LETRAVE ME VLERE U PRANUA SI ANETAR ME TE DREJTA TE BARABARTA I IOSCO, ORGANIZATA NDERKOMBETARE E KOMISIONEVE TE LETRAVE ME VLERE.

Rregullatorët e tregut të letrave me vlerë, që janë përgjegjës për të siguruar standarte të larta, integritet dhe mbrojtjen e investitorëve, duhet të adaptojnë në mënyrë të vazhdueshme kuadrin ligjor dhe procedurat në përshtatje të mjedisit, që ndryshon vazhdimisht. Ata duhet të bëjnë gjithçka, që është e mundur për t'i krijuar mundësinë investitorëve të përfitojnë nga globalizimi i tregut duke ruajtur standartet e transparencës, integritetit dhe mbrojtjes së investitorëve. Tashmë është e qartë se rregullatorët mund të realizojnë strategjinë dhe objektivat e tyre vetëm nëse angazhohen në një bashkëpunim ndërkombëtar dhe në rast se punojnë nga afër me tregjet. IOSCO është motori i kësaj përpjekje globale bashkëpunimi.

PERMBAJTJA E LENDES

Struktura Organizative e KLV

Aktiviteti i Komisionit

Drejtimet Kryesore

Legjislacioni

Rregulloret e miratuara gjatë 1998

Legjislacioni i përgatitur gjatë 1998

Liçencimi

Masat Disiplinore

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Vështrim i përgjithshëm mbi tregun

Synimet për të ardhmen


Situacioni Financiar

Shtojca

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMISIONIT TE LETRAVE ME VLERE

Komisioni i Letrave me Vlerë (KLV), si autoritet i vetëm rregullator i Tregut të Letrave me Vlerë, është krijuar dhe vepron në mbështetje të Ligjit Nr.8080, datë 1.3.1996, "Për Letrat me Vlerë" si dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.696, datë 14.10.1996, me seli pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Komisioni i Letrave me Vlerë përbëhet nga shtatë komisionerë, të cilët emërohen me propozim të Presidentit të Republikës dhe me miratim të Kuvendit Popullor. Komisioni mbledhet në takime të rregullta, ku merren vendime, përcaktohen prioritetet, diskutohet për programet në vazhdimësi dhe ato të perspektivës.



Bordi i Komisionerëve gjatë vitit 1998 *

Elisabeta GJONI Kryetar i Komisionit të Letrave me Vlerë

Albina KARAMITRO Komisioner

Ilirian RUSMALI Komisioner

Marjan GJERMENI Komisioner

Selami XHEPA Komisioner

*Dy vende janë vakante

Struktura e Departamenteve dhe FunkSIONET

Misioni i Komisioni të Letrave me Vlerë është:

- të sigurojë standarte të larta për mbrojtjen e investitorëve në letrat me vlerë;
- të nxisë besueshmërinë në efikasitetin e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri, në mënyrë që të mbështesë zhvillimin e tij të vazhdueshëm;
- të gjejë balancën e përshtatshme midis masave, që sigurojnë mbrojtjen e investitorëve dhe masave, që inkurajojnë zhvillimin dhe modernizimin e tregut;
- të mbikqyrë efektivisht aktivitetet e tregjeve të letrave me vlerë, institucionet, që kryejnë pastrimin dhe rregullimin e llogarive dhe aktivitetin e pjesëmarrësve të tregut;
- të kryejë të gjitha funksionet dhe detyrat e tjera të parashikuara në Ligj.

Struktura e Komisionit të Letrave me Vlerë (KLV) është përshatur për të kryer sa më mirë aktivitetin dhe plotësuar objektivat e Komisionit. Në të ardhmen, në varësi të ndryshimit të prioritetëve, sektorëve mund tu jepet statusi i divizionit.

Divizioni i Liçencimit dhe Monitorimit

Divizioni i Liçencimit dhe Monitorimit është përgjegjës për të siguruar që, të gjitha kërkesat e liçencimit janë plotësuar në përputhje me kërkesat e Ligjit. Divizioni ka këto detyra kryesore:

- Shqyrton kërkesat për liçencim të paraqitura nga subjektet e ndryshme.
- Mbikqyr veprimtarinë e të liçencuarve duke marrë në konsideratë gjendjen financiare, kontrollin e brendshëm, shkallën e cilësisë së veprimtarisë si dhe aftësinë profesionale të personelit të punësuar e atë të trupit drejtues.
- Mban regjistrin e shoqërive të liçencuara, subjektet apo përfaqësuesit e tyre.
- Bashkëpunon me divizionet e tjera, sidomos me atë të Drejtave Imponuese dhe Disiplinimit, kur zbulon se ka shkelje të dispozitave ligjore dhe kërkon hetime të mëtejshme.

Divizioni i Mbikqyrjes së Tregut

Misioni i këtij divizioni është mbikqyrja dhe nxitja e zhvillimit të tregut të kapitaleve. Divizioni ka këto detyra kryesore:

- Mbikqyrja e aktivitetit të tregtimit në tregun e letrave me vlerë, rregullimi i transaksioneve dhe pastrimi i llogarive.
- Promovimi dhe zhvillimi i një sistemi vetrregullues si dhe i tregut të drejtë.

Divizioni i të Drejtave Imponuese dhe Disiplines

- Heton tregtimet e dyshimta në aktivitetin e letrave me vlerë.
- Siguron përputhshmërinë me Ligjin dhe rregulloret.
- Propozon masa disiplinore dhe u jep organeve përkatëse informacionet e nevojshme për investigime të mëtejshme në rast shkelje të Ligjit.
- Shërben për mbarëvajtjen e marrëdhënieve me publikun dhe vlerësimin e ankesave të investitorëve.

Divizioni i Shoqërive Tregtare

Divizioni i Shoqërive Tregtare kryen funksionet e mëposhtme:

- Siguron një ekspozim të plotë të informacionit të nevojshëm që ndikon tregtimin e letrave me vlerë të ofruara apo të tregtuara.
- Siguron trajtim të drejtë dhe të barabartë të zotëruesve të aksioneve.
- Ndhmon në zhvillimin e një tregu kapitalesh eficient dhe efektiv si për instrumentat e borxhit, ashtu dhe ato të kapitalit.
- Harton strategjitë dhe rregulloret në përputhje me tendencat vendase dhe ato të tregut të huaj

Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Ky sektor është përgjegjës për krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të Komisionit të Letrave me Vlerë.

Sekretariati

Sekretariati shërben për organizimin e mbledhjeve të Komisionit dhe Komiteteve. Sekretariati merret me çështjet administrative të Komisionit. Sektori juridik, si pjesë e sekretariatit, i ofron këshillim ligjor Komisionit dhe divizioneve jo vetëm nëpërmjet burimeve të brendshme, por edhe nëpërmjet ekspertëve jashtë institucionit. Ai mbikqyr përputhshmërinë e rregullave në mbledhjet e Komisionit si dhe ndihmon në zbardhjen e vendimeve të Komisionit. Ky sektor është i angazhuar në shqyrtimin e imtësishëm të ligjeve dhe rregulloreve.

Administrata

Administrata është e angazhuar në kryerjen e të gjitha detyrave administrative dhe financiare për funksionimin e Komisionit.

AKTIVITETI I KOMISIONIT TE LETRAVE ME VLERE GJATE 1998

Drejtimit Kryesore

Ndërkohë që zhvillimet e tregut të kapitaleve vazhdojnë të jenë të kufizuara, Komisioni është përpjekur të përmbushë detyrat e përcaktuara në misionin dhe nga ligji "Për Letrat me Vlerë". Drejtimit kryesore të punës së Komisionit gjatë 1998 kanë qënë:

- Miratimi i rregulloreve të kërkuara nga Ligji si dhe shtesa e përmirësime të rregulloreve ekzistuese.
- Hartimi i Projekt-Ligjit të ri "Mbi Investimet Kolektive në Fondet e Letrave me Vlerë" si dhe disa prej akteve nënligjore.
- Vendosja dhe forcimi i marrëdhënieve dhe i bashkëpunimit ndërkombëtar.

Legjislacioni

Legjislacioni, që administrohet nga Komisioni:

- Ligji Nr. 8080, "Për Letrat me Vlerë", dt. 01.03.1996
- Rregullore Nr. 1, "Mbi Liçencimin, Kuotat dhe Komisionet", dt. 28.03.1997
- Rregullore No.2 , "Mbi Burimet për Kërkesat Financiare dhe Kontabël", dt. 02.05.1997
- Rregullore Nr.3, "Mbi publikimet në Veprimatrinë e Investimit në Letrat me Vlerë" *, dt. 12.05.1997 *
- Rregullore Nr. 4, "Mbi Funksionimin e Komisionit të Letrave me Vlerë", dt. 01.08.1997
- Rregullore Nr. 5, "Mbi Funksionimin e Administratës së Komisionit të Letrave me Vlerë", dt. 01.08.1997
- Rregullore Nr. 6, "Mbi kërkesat Financiare dhe ato Kontabël të të Liçencuarve", dt. 19.08.1997 *
- Rregullore Nr.7, "Mbi Etikën në Veprimatinë e Investimit në Letrat me Vlerë", 19.08.1997 *
- Rregullore Nr. 8, "Mbi Detyrimet për Përgatitjen e Prospektit", 19.12.1997
- Rregullore Nr. 9, "Mbi Detyrimin e Emetuesve për Informim të Vazhdueshëm" dt. 13.01.1998 *

- Rregullore Nr.10, "Mbi Marrjen e Paketës Kontrolluese të Aksioneve", dt. 21.12.1998

* Projekt-Vendim Qeverie. Data, është data e përgatitjes së rregulloreve nga Komisioni.

Rregulloret e miratuara gjatë vitit 1998

Gjatë këtij viti, Komisioni ka vazhduar punën për përgatitjen dhe miratimin e rregulloreve, që kërkohen nga Ligji "Per Letrat me Vlerë".

Komisioni ka miratuar rregulloren "*Mbi Detyrimin e Emetuesit për Informim të Vazhdueshëm*", rregullore e cila i është dërguar për miratim Këshillit të Ministrave. Kjo rregullore do t'i japë jete njërit prej aktiviteteve me të rendësishme të tregut , atë të informimit të vazhdueshëm të publikut. Kjo rregullore gjen zbatim vetëm për letrat me vlerë si aksione, obligacione dhe garanci, të cilat i ofrohen publikut apo mbahen nga publiku. Letrat me vlerë mbahen nga publiku, në qoftë se emetuesi ka publikuar fllimisht një prospekt, që është regjistruar nga Komisioni; letrat me vlerë janë të regjistruara apo janë pranuar të tregtohen në tregun e letrave me vlerë; emetuesi ka më shumë se 100 aksionmbajtës apo Komisioni i bën të ditur emetuesit këto efekte. Komisioni kërkon nga shoqëritë, aksionet e të cilave mbahen nga publiku, të japin informacion të vazhdueshëm, që mund të ndikojë tek aksionmbajtësit. Ky informacion varion që nga publikimi i llogarive financiare, raporteve vjetore apo të ndërmjetme në lidhje me futjen në zotërim të aseteve, transaksioneve ndërmjet shoqërive dhe filialeve të saj si dhe njoftimin për mbledhjen e asamblesë së aksionerëve. Emetuesi duhet t'i japë këtë informacion Komisionit, bursës, në të cilën aksionet janë listuar, si dhe aksionmbajtësve. Komisioni mund të ndër marrë masa ndaj shoqërive apo drejtorëve që nuk zbatojnë këto rregulla. Komisioni mund të vendosë të publikojë informacionin si dhe mund të vendosë sanksionet si gjopa apo pezullim të tregtimit.

Komisioni ka miratuar rregulloren "*Për Marrjen e Paketës Kontrolluese të Aksioneve*". Kjo rregullore gjen zbatim në të gjithë ofertat për marrjen e paketës kontrolluese të aksioneve apo për bashkimin e shoqërive aksionere, të cilat janë të regjistruara në Shqipëri. Objektivi është sigurimi i një trajtimi të drejtë dhe të barabartë të aksionerëve, që preken nga transaksionet për marrjen e paketës së aksioneve. Trajtimi i drejtë mund të arrihet përmes sigurimit të barazisë së aksionerëve, dhënies në kohë të informacionit të duhur që mundëson marrjen e vendimeve të mirë informuara. Marrja e paketës kontrolluese ka rrezikun e shoqërimit me tregtime dhe përfitime jo drejta. Rregullorja e marrjes së paketës kontrolluese përpiqet ta rregullojë këtë nëpërmjet vëzhgimit të këtij procesi dhe imponimit të rregullave të lojës. Një subjekt apo një grup njerëzish që veprojnë së bashku, që vihen në zotërim të një shoqërie (më shumë se 50% të votave) apo vihen në zotërim të aksioneve, që i japin atyre kontrollin mbi shoqërinë duhet të bëjë një ofertë të përgjithshme të detyrueshme për çdo kategori aksionesh të shoqërisë. Oferta për marrjen e paketës kontrolluese duhet të bëhet brenda kohës së përcaktuar, me qëllim që t'u jepet aksionerëve mundësia për të marrë një vendim të mirëinformuar. Të gjithë

personat, që janë të angazhuar në marrjen e paketës së aksioneve duhet të marrin të gjitha masat, që të shmangin daljen e informacionit dhe tu binden rregullave për te eliminuar avantazhet. Publiku ka të drejtë të informohet për çdo ndryshim të rëndësishëm (më shume apo më pak se 20% e të drejtave të votës).

Legjislacioni i përgatitur gjatë 1998

Projekt-Ligji "Mbi investimet kolektive në fondet e investimeve", ka qenë një ndër prioritet e verpimtarisë së Komisionit gjatë 1998. Objektivi i këtij Ligji është mbrojtja e investitorëve, duke ndaluar promovimin e fondeve kolektive me përjashtim të rasteve në cilin këto janë të liçencuara nga Komisioni, si dhe duke rregulluar veprimtarinë e këtyre fondeve të liçencuara. Projekt-Ligji nxit krijimin e fondeve në dy mënyra: fondet e krijuara në baze të një kontratë, të quajtura fonde investimesh dhe fondet që krijohen si shoqëri aksionere, të quajtura shoqëri investimi. Projekt-Ligji përcakton kërkesat për liçencim. Projekt - Ligji përbën kuadrin ligjor të detyrueshëm për rregullimin e fondeve kolektive, ndërkohë që një pjesë e mirë e tyre do të rregullohen nga rregulloret, që do të miratohen nga Komisioni dhe Këshilli i Ministrave. Në hartimin e këtij Projekt - Ligji, është synuar që ai të jetë në përputhje me Direktivat e Komunitetit European dhe parimet e IOSCO. Komisioni ia ka paraqitur për opinion dhe diskutim këtë Projekt - Ligj institucioneve të ndryshme dhe brenda një kohe të shkurtër do t'ia paraqesë për miratim Parlamentit.

Aktiviteti i Liçencimit

"Rregullore e Liçencimit, Kuotave dhe Komisioneve"

Në këtë Rregullore theksohet se vetëm kompanitë e organizuara si shoqëri aksionere kanë të drejtë të aplikojnë për të vepruar në Bursë. Këto shoqëri si dhe përfaqesuesit e tyre duhet të plotësojnë Formë-Kërkesat e hartuara nga Komisioni, si dhe duhet të bashkëngjisë dokumentat përkatëse që kërkohen në bazë të Ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

Formë-kërkesa e plotësuar nga një shoqëri aksionere duhet të jetë e shoqëruar nga:

- Bilanci i tre viteve të fundit financiare si dhe Pasqyra e të Ardhurave dhe e Shpenzimeve;
- një kopje e statutit të shoqërisë bashku me një kopje të regjistrimit në gjykatë;
- si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga Komisioni në formë – kërkesë, në varësi të aktivitetit për të cilin aplikohet.

Formë-kërkesa e plotësuar nga individët përfaqësues duhet të jetë e shoqëruar nga:

- Curriculum Vitae;
- Kopje e noterizuar e Diplomës së shkollës së lartë (nëse ka);
- Mandati i autorizimit nga shoqëria;
- Dy letra reference nga persona, që kanë njohuri mbi aftësitë e tij profesionale.

Për marrjen e Liçencës aplikuesit duhet të paguajnë tarifën e caktuar në këtë Rregullore, e cila ndryshon sipas aktivitetit për të cilin aplikohet. Në rast se Liçenca humb apo bëhet e pavlefshme, Komisioni pasi bindet për këtë bën zëvendësimin e saj kundrejt tarifës së caktuar. Në rast se i liçencuari, dëshiron të ndërrojë aktivitetin për të cilin është liçencuar fillimisht, ai dorëzon liçencën e parë dhe i nënshtrohet procesit të riliçencimit sipas rastit.

Komisioni i Letrave me Vlerë deri tani ka ndjekur një politike, që synon pjesëmarrjen në treg të një numri sa më të madh subjektesh. Për këtë arsye shërbejnë dhe kërkesat e kufizuara, të përcaktuara në formularët e pranimit si dhe tarifat e arsyeshme, të vendosura nga Komisioni për këta pjesëmarres. Gjithashtu Komisioni ka ndjekur politikën e dhënies së liçencave të përkohshme me qëllim që t'i lihet vend zhvillimeve të tregut si dhe perpunimit të praktikave të ndjekura.

Komisioni duke patur parasysh nivelin e zhvillimit të tregut të kapitaleve, ka vazhduar të liçencojë tregtarë, duke i lejuar ata të kryejnë transaksione vetëm për llogari të tyre dhe vetëm në letra me vlerë të qeverisë.

Gjatë 1998, tre subjekte të reja kanë aplikuar për të marrë liçencën për të vepruar në tregun e letrave me vlerë. Komisioni i Letrave me Vlerë ka rinovuar apo u ka dhënë liçence tregtari gjashtë subjekteve dhe përfaqësuesve të tyre. Subjektet e liçencuara janë kryesisht banka private apo shtetërore.

Komisioni ka ndjekur politikën e liçencimit të përkohshëm me objekt aktiviteti të përcaktuar mirë. Kjo politikë mendohet të jetë me shumë fleksible dhe e besueshme duke pasur parasysh dinamikën e tregut në të ardhmen. Së bashku me zgjerimin e aktivitetit të tregut, Komisioni do të rivlerësojë strategjinë e tij të liçencimit me qëllim që të arrijë përmirësimin cilësor të shërbimive të ofruara nga të liçencuarit.

Ajo çfarë duhet të theksohet është, se numri i subjekteve jo banka ka qenë i vogël. Komisioni i ka asistuar gjatë gjithë kohës këta aplikantë në përmbushjen e kërkesave për liçencim. Komisioni ka përgatitur teste profesionale, të cilave do t'u nënshtrohen individët, që aplikojnë për liçencë.

<i>Viti</i>	<i>Aplikime të reja</i>	<i>Liçenca të dhëna</i>	<i>Rinovime</i>	<i>Numri total i shoqërive të liçencuara</i>	<i>Numri total i përfaqësuesve të liçencuar</i>

1996	7	6	-	6	9
1997	3	1	6	7	14
1998	3	2	4	6	14

Masat Disiplinore

Ndonëse aktiviteti i tregut ka qenë i vogël Komisioni ka vëzhguar vazhdimisht tregun për çdo rast papajtueshmëre me rregullat dhe ligjin "Për Letrat me Vlerë"

Gjatë 1998, Komisioni u ndesh me dy raste ndaj të cilave u morën masa disiplinore: një shoqëri tentoi të shiste aksione për publikun nëpërmjet internetit, duke shkelur kërkesat për publikime dhe rregulloren e Prospektit. Komisioni kërkoi menjëherë që shoqëria të tërhiqte reklamën dhe publikimet e saj në lidhje me këtë ofertë, duke ndaluar shitjen e aksioneve.

Shoqëria tjetër publikoi një reklamë, në të cilën propagandohej miratimi i Qeverisë për aktivitetin e tyre, gjë që përbënte shkelje të rregullores mbi publikimet. Shoqëria, më pas me kërkesë të Komisionit korrigjoi këtë reklamë.

BASHKEPUNIMI NDERKOMBETAR

Komisioni i Letrave me Vlerë edhe gjatë vitit 1998 i ka kushtuar një vëmendje të rëndësishme krijimit dhe forcimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Objektivi i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi i informacionit, shkëmbimi i eksperiencës si dhe ndihma në asistencë teknike.

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO)

Një nga ngjarjet me të shënuara ishte pranimi i Komisionit të Letrave me Vlerë si anëtar me të drejta të barabarta i IOSCO, në Konferencën Vjetore të mbajtur në Nairobi, Kenia në Shtator 1998. Pjesëmarrja e Komisionit të Letrave me Vlerë në IOSCO është një provë e angazhimit të Komisionit në mbrojtjen e investitorëve dhe të integritetit të tregut. Anëtarët e IOSCO janë të vendosur:

- të bashkëpunojnë për të siguruar rregullimin sa më të mirë të tregut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar,
- të shkëmbejnë informacion mbi eksperiencat përkatëse, me qëllim që të nxisin zhvillimin e tregut lokal,

- të bashkojnë forcat për të krijuar standarte dhe mbikqyrur transaksionet ndërkombëtare në letrat me vlerë,
- të sigurojnë asistencë shumëpalëshe me qëllim mbrojtjen e integritetit të tregjeve nëpërmjet aplikimit rigoroz të sandarteve dhe masave disiplinore për çdo shkelje.

Komisioni i Letrave me Vlerë si pjesë e strukturave të IOSCO është anëtar i Komitetit të Tregjeve të Reja (EMC) të IOSCO, si dhe është anëtar në Grupin e Punës I të IOSCO. Komisioni i Letrave me Vlerë është gjithashtu anëtar i Komitetit Rajonal European. Që nga Shtatori 1998, Komisioni i Letrave me Vlerë ka marrë pjesë në seminarët dhe mbledhjet e organizuara nga IOSCO.

FSVC (Korpusi Vullnetar për shërbimin financiar) / USAID (Agjensia Ndërkombëtare e Zhvillimit të Shteteve të Shteteve të Bashkuara)

Gjatë 1998, Komisioni i Letrave me Vlerë është asistuar nga FSVC/USAID, asistencë, e cila ka qenë mbështetje financiare për trainimin e stafit të Komisionit. FSVC mundësoi pjesëmarrjen e Komisionit të Letrave me Vlerë në Konferencën vjetore të IOSCO, në trainimet e ndryshme të organizuara nga IOSCO dhe CEEPN. FSVC gjithashtu mundësoi gjatë muajit Korrik 1998 trainime të stafit të Komisionit, të ofruara nga US SEC. Komisioni ka përcaktuar një program bashkëpunimi me FSVC për organizimin e Konferencës " Alternativa për Tregun e Letrave me Vlerë në Shqipëri".

British Know How Fund (Fondacion i Asistencës së Qeverisë Britanike)

Komisioni edhe gjatë këtij viti ashtu si dhe gjatë tre viteve të kaluar, ka bashkëpunuar me Know How Fund në drejtime të ndryshme. Asistenca e Know How Fund ka qenë tepër e çmuar në konceptimin e kuadrit ligjor të tregut të kapitaleve në Shqipëri. Bashkëpunimi me të ka luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e strategjisë së zhvillimit. Për tu përmendur është edhe kontributi, që Know How Fund ka dhënë për ngritjen nga pikëpamja institucionale të Komisionit të Letrave me Vlerë.

Gjatë 1998 Know How Fund e zgjeroi programin e bashkëpunimit duke sjellë dhe një konsulent të ri pranë Komisionit dhe Bursës së Tiranës për zhvillimin e strategjisë së tregut të kapitaleve në Shqipëri.

Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës i Shteteve të Bashkuara (US SEC)

Komisioni i Letrave me Vlerë ka krijuar lidhje të ngushta bashkëpunimi me US SEC:

- Trainime dhe seminare. Komisioni ka marrë pjesë në tre prej programeve trainuese dhe seminareve të organizuara nga US SEC.
- Trainim gjatë punës. Një këshilltar i US SEC vizitoi KLV dhe ofroi konsulencë në procedurat e licencimit, procesin e ekzaminimit, strukturën e Komisionit, kuadrin ligjor etj.
- Shkëmbim informacioni dhe bashkëpunim për masat disiplinore të ndërmarra nga Komisioni.

Organizata për Privatizimi në Europën Lindore dhe Qëndrore (CEEPN)

Komisioni ka vazhduar të mbajë marrëdhënie me CEEPN dhe ka marrë pjesë në seminarët dhe konferencat e organizuara prej CEEPN për tregjet e kapitaleve dhe privatizimin.

Bashkëpunim me insitucionet analoge

Komisioni ka ndërmarrë hapat e para për programet e bashkëpunimit me Komisioni Kombëtar për Shoqëritë dhe Bursën (CONSOB) Itali, si dhe autoritetin e tregut të kapitaleve të Greqisë.

VEZHGIM MBI TREGUN

Situata Ekonomike

- Në përgjithësi 1998 është karakterizuar nga përmirësimi i situatës ekonomike të vendit. Rritja ekonomike vlerësohet të jetë 8% ndonëse kjo nuk reflekton parashikim për një shifër me dy numra. Bujqësia dhe ndërtimi përbëjnë rreth 70% të kësaj rritje ndërkohë që ndikimi i prodhimit industrial ishte i vogël.
- Inflacioni pati rënie nga 44.6 % në Janar në 16.5% në Shtator dhe në 8.7% në fund të Dhjetorit 1998 (në nivel vjetor).
- Inflacioni në rënie, kurse të qëndrueshme këmbimi dhe faktorë të tjerë bënë të mundur që Banka e Shqipërisë të adaptojë politikën e normave të interesit në ulje për depozitat në Lekë. Këto norma interesi nga 22% në Korrik u ulën në 20% në Gusht dhe më vonë në 18% për të arritur në fund të Nëntorit 1998 në 16.5%.
- Agregati M3 për nëntë muajt e parë të vitit pati një rritje prej 13.8%. Kjo reflekton një ulje prej 7% të parave jashtë shtetit bankar, 21% të depozitave rrjedhëse dhe nga ana tjetër një rritje 49% të nivelit të depozitave.
- Shpenzimet qeveritare dhe defiçiti buxhetor në përgjithësi janë mbajtur në kontroll, megjithë vështirësitë e hasura për të mbuluar defiçitin, kryesisht në thithjen e fondeve të huaja dhe në sigurimin e parave nga procesi i privatizimit (98 milion Lekë nga 1.5 miliard që ishin parashikuar).
- Papunësia nga 14.9% në fund të Dhjetorit 1997 në 16.9% në Dhjetor 1998.
- Një nga kërkesat kryesore për rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike të vendit mbetet vendosja e rendit.

Tregu i letrave me vlerë në Shqipëri është akoma në hapat e tij të para. Ndonëse tashmë janë krijuar disa institucione, sasia e askioneve të disponueshme është e vogël dhe ndërmarrja e aktivitetit ndërmjetësues është e kufizuar me përjashtim të iniciativave të disa bankave.

Në këto kushte edhe gjatë 1998, Bursa e Tiranës vazhdoi të veprojë si një treg paraje duke tregtuar vetëm letra me vlerë të qeverisë me maturim 3, 6 and 12 mujor. Totali i volumit të transakcioneve të kryera ishte 4,959 milion Lekë në 21 sesione, mesatarja e të cilave është rreth 593 milion Lekë për sesion (shih shtojcën). Gjatë kësaj periudhe Banka Kombëtare Tregtare ishte shitësi kryesor, kjo e kushtëzuar dhe nga nevoja për likuiditete. Nga ana tjetër është Banka e Kursimeve që ka akumuluar një sasi të madhe parash nga depozitat (80% e totalit të depozitave), dhe ka qenë një nga blerësit kryesor të bonove të thesarit.

Gjatë 1998, Bonot e Thesarit reflektojnë një normë kthimi pozitive, me një yield më të lartë se inflacioni (që nga Marsi). Megjithëse ky fakt ka tërhequr një numër në rritje të individëve dhe institucioneve jo bankare, numri i tyre vazhdon të jetë i vogël. Kështu, në qoftë se në fund të 1997, këta përfaqësonin vetëm 1.14%, në Korrik 1998, kjo shifër ishte 1.98%. Tregu dominohet kryesisht nga Banka e Kursimeve, e cila ka rreth 77% të tregut.

Në Korrik me vendim të Bordit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë, organizimi i ankandit të bonove të thesarit iu kalua Departamentit të Operacioneve Monetare, pranë Bankës së Shqipërisë.

Një çështje e rëndësishme vazhdon të jetë krijimi i një Burse të pavarur. Banka e Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave kanë rënë dakort për krijimin e një burse të pavarur, proces, i cili shtron përpara një sërë kërkesash:

- Si do të financohet krijimi i bursës? A do të angazhohen privatët në këtë proces? Në çfarë mase do të jetë ky angazhim?
- Cila do të jetë forma e këtij institucioni? A do të ketë formën e një shoqërie fitimprurëse?
- Cili do të jetë aktiviteti i Bursës? A duhet të tregtojë bono thesari? Duhet të përqendrohet vetëm në tregtimin e aksioneve apo të shtrihet dhe në aktivitetin e këmbimit të valutave?

Proçesi i privatizimit konsiderohet si një element tjetër kyç për krijimin e tregut të kapitaleve. Ndonëse sot janë krijuar disa kompani aksionere, privatizimi i sektorit strategjik mendohet se do të çojë në lindjen e një grupi aksionerësh, që do të kenë nevojë të tregtojnë instrumentat e tyre. Në rast se Qeveria do të realizojë objektivin e saj për shpërndarjen e 20% të aksioneve të sektorit strategjik publikut, kjo do të përbëjë dhe një hap përpara në krijimin e tregut të kapitaleve në Shqipëri.

PROJEKTET PER TE ARDHMEN

Veprimtaria e Komisionit të Letrave me Vlerë gjatë 1999 do të synojë:

- *Plotësimin e kuadrit ligjor për letrat me vlerë*

Synimi i Komisionit është që gjatë 1999 t'i paraqesë për Miratim Parlamentit Projekt - Ligjin "Mbi Investimet Kolektive në Fondet e Letrave me Vlerë" si dhe përgatisë aktet e nevojshme nënligjore.

Komisioni do të vazhdojë të punojë për përgatitjen e rregulloreve të përcaktuara në ligjin "Për Letrat me Vlerë".

- *Krijimi dhe përmirësimi i procedurave, praktikave të aktivitetit të tregut*

Megjithëse Komisioni i Letrave me Vlerë ka miratuar një numër rregulloresh, që rregullojnë tregun e kapitaleve, ndihet nevoja për përgatitjen e procedurave dhe praktikave për administrimin dhe zbatimin e këtyre rregulloreve.

Procedurat e liçencimit do të zgjerohen më tej duke përfshirë të gjitha llojet e liçencave, që mund të jepen nga Komisioni si dhe kërkesat e sakta për çdo aplikant.

Komisioni i Letrave me Vlerë, në bashkëpunim me partnerët e huaj, do të synojë në krijimin e modeleve standarte, që do të rregullojnë marrëdhëniet midis tregtarëve dhe klientëve të tyre si dhe do të përgatisë kërkesa të detajuara për publikim për pjesëmarrësit e tregut.

Në qoftë se procesi i privatizimit, do të arrijë objektivat strategjike, për kompanitë do të jetë i nevojshëm listimi i aksioneve në bursë, gjë, që kërkon, që Bursa dhe Komisioni i Letrave me Vlerë të përgatiten për të trajtuar të gjitha nevojat praktike të këtij zhvillimi.

- *Programi i ndërgjegjësimit të publikut*

Komisioni i Letrave me Vlerë do rrisë përpjekjet e tij për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me biznesin e investimit në letrat me vlerë si dhe njohjen e Komisionit si institucioni rregullator. Broshura, fletë palosje e prezantime do të përgatiten dhe do t'u shpërndahen subjekteve të interesuara. Komisioni do të organizojë simpoziume dhe seminare, që kanë të bëjnë me zhvillimin strategjik dhe çështjet, që kanë të bëjnë me edukimin dhe trainimin. Në 1998 Komisioni krijoi faqen e tij në internet, faqe që do të plotësohet më tej në të ardhmen dhe do të shërbejë si burim kryesor informacioni mbi aktivitetin e Komisionit.

- *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*

Edhe për vitin 1999 një nga prioritetet e Komisionit do të jetë bashkëpunimi me IOSCO, duke synuar njohjen e zhvillimeve dhe tendencave, si dhe përfshirjen në aktivitetet e organizuara nga IOSCO.

Vëmendje do t'i kushtohet krijimit të lidhjeve me institucionet analoge, sidomos përsa u përket Marrëveshjeve të Mirëkuptimit dhe Programeve të Bashkëpunimit.

- *Koordinimi dhe Bashkëpunimi me subjektet private, që luajnë një rol aktiv në zhvillimin e tregut të kapitaleve.*

Krijimi i Bursës së Tiranës, si një organizëm i pavarur, kërkon koordinimin e përpjekjeve dhe bashkëpunimin e të gjitha subjekteve të interesuara dhe të përfshira në këtë proces. Duhet të ndërmerren një sërë hapash, me qëllim krijimin e një organi të suksesshëm, që do të operojë me eficiencë dhe të plotësojë kërkesat rregullatore.

- *Hapa të mëtejshme për ristrukturimin institucional dhe zhvillimin e Komisionit të Letrave me Vlerë*

Struktura e Komisionit është një strukturë mjaft fleksibël dhe mund të adaptohet dhe ndryshohet për plotësimin e detyrave të Komisionit. Komisioni do të punojë për të hartuar një kod etike, i cili do të rregullojë funksionimin e brendshëm të Komisionit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i aktivitetit të Komisionit është trainimi i vazhdueshëm i stafit të tij.

SITUACIONI FINANCIAR 1998

Komisioni i Letrave me Vlerë, në mbështetje të Ligjit Nr.8080, datë 01.03.1996, "Për Letrat me Vlerë", është një institucion vetëfinancues, i cili për funksionet dhe shërbimet që kryen, ngarkon kuota dhe tarifa, që shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve. Në kushtet aktuale kur këto kuota janë shumë të vogla dhe, kur numri i të licencuarve është gjithashtu i vogël, ky Komision mbështetur në nenin 13, Ligji Nr. 8080, financohet nga buxheti i shtetit.

Kontabiliteti i Komisionit mbahet në konformitet me "Standartet e Kontabilitetit", që zbatohen në Republikën e Shqipërisë.

Burimet buxhetore dhe përdorimi i tyre


<i>Zërat</i>	<i>Plani</i>	<i>Fakti</i>
<i>Pagat & Sigurimet Shoqërore</i>	4,605 ,000	2,752,442
<i>Shpenzimet Operative</i>	7,558,000	6,288,914
<i>Paisjet</i>	3,994,700	3,993,347
TOTALI	18,299,700	13,034,703

Fondet e veta

<i>Të ardhurat 1998</i>	505,000
<i>Nga viti i kaluar</i>	210, 485
Totali i të ardhurave	715,485
Shpenzimet	53,000
TE ARDHURAT NETO	662,485

SHTOJCA


Depozitat, Bonot e Thesarit, Inflacioni




		3-mujore	
	B. TH	Depozita	Inflacioni
Janar	34.92	26.00	44.60
Shkurt	31.23	26.00	39.80
Mars	30.66	26.00	24.00
Prill	30.00	26.00	28.00
Maj	28.62	24.00	26.43
Qershor	28.96	22.00	17.84
Korrik	26.90	22.00	16.90
Gusht	26.35	20.00	16.67
Shtator	24.28	20.00	16.48
Tetor	24.12	18.00	11.18
Nëntor	22.58	16.50	8.94
Dhjetor	20.60	16.50	8.69

		6-mujore	
	B.TH.	Depozita	Inflacioni
Janar	34.40	26.00	44.60
Shkurt	32.35	26.00	39.80
Mars	32.34	26.00	24.00

Prill	31.82	26.00	28.00
Maj	30.35	24.00	26.43
Qershor	30.22	22.00	17.84
Korrik	27.24	22.00	16.90
Gusht	26.28	20.00	16.67
Shtator	24.72	20.00	16.48
Tetor	24.33	18.00	11.18
Nëntor	22.94	16.50	8.94
Dhjetor	21.67	16.50	8.69



12-mujor			
	B.TH.	Depozita	Inflacioni
Janar	34.80	27.00	44.60
Shkurt	34.50	27.00	39.80
Mars	33.60	27.00	24.00
Prill	32.30	27.00	28.00
Maj	32.30	24.00	26.43
Qershor	31.32	21.00	17.84
Korrik	27.90	21.00	16.90
Gusht	26.88	20.00	16.67
Shtator	24.88	20.00	16.48
Tetor	24.50	18.00	11.18
Nëntor	23.50	16.50	8.94
Dhjetor	22.90	16.50	8.69




Yieldi për Bonot e Thesarit			
Në përqindje			
	3-mujore	6-mujore	12-mujore
Janar	34.92	34.40	34.80
Shkurt	31.23	32.35	34.50
Mars	30.66	32.34	33.60
Prill	30.00	31.82	32.30
Maj	28.62	30.35	32.30
Qershor	28.96	30.22	31.32
Korrik	26.90	27.24	27.90
Gusht	26.35	26.28	26.88
Shtator	24.28	24.72	24.88
Tetor	24.12	24.33	24.50
Nëntor	22.58	22.94	23.50
Dhjetor	20.60	21.67	22.90

Volumi i Transaksioneve ne tregun sekondar te Tregtuara ne Burse gjate 1998						
					in 000 Leks	
	Nr	për muaj			Nr. i transaksioneve	
	Sesioneve	Volumi i	Sesionet	per transaksion	per	per sesion

		Tregtimit			muaj	
Janar	1	2,100,000	2,100,000	1,050,000	2	2
Shkurt	1	15,000	15,000	15,000	1	1
Mars	1	15,000	15,000	15,000	1	1
Prill	1	250,000	250,000	62,500	4	4
Maj	3	499,000	166,333	249,500	2	0.7
Qershor	3	680,000	226,667	113,333	6	2
Korrik	6	580,000	96,667	64,444	9	1.5
Gusht	2	570,000	285,000	142,500	4	2
Shtator	1	200,000	200,000	200,000	1	1
Tetor	2	50,000	25,000	12,500	4	2
Nëntor	0	-	-	-	0	0
Dhjetor	0	-	-	-	0	0
Totali	21	4,959,000			34	
Mesatarja		593,167	236,143	250,889	5.7	

Portofoli i B.TH. 30 Shtator 1998



Në milion Leke

Banka e Shqipërisë	BoA	18,920.00
Banka e Kursimeve	SB	86,824.11
Banka Kombëtare Tregtare	NCB	497.72
Banka Dardania	DB	33.23
Banka Italo Shqiptare	IAB	297.18
Banka Ndërkombëtare Tregtare	ICB	66.36
Banka FEFAD	FEFAD	60.37
Banka Kombëtare Greke	NBG	50.00

Banka Alpha Credit	ACB	181.94
Banka Tirana	TB	400.00
Institucione Fin. jo Bankare	NFI	1,521.89
Individ dhe kompani	I&C	259.24
INSIG	INSIG	1,170.84
Totali		110,282.87

Tregusit Ekonomik									
	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998
Prodhi dhe Shpenzimet	(ndryshimi në përqindje)								
Rritja e PPB	-10.0	-28.0	-7.2	10.0	8.3	13.3	9.1	-7.0	8.0
Prodhi industrial	-14.2	-42.0	-51.2	-10.0	-2.0	6.0	13.6	-5.6	4.1
Prodhi bujqësor	-5.4	-17.4	18.5	10.4	8.3	13.2	3.0	1.0	5.0
Ndertimi	-12.0	-30.0	7.0	30.0	15.0	21.0	18.0	-6.3	21.0
Transporti	-10.0	-30.0	-15.0	13.0	18.0	19.0	-1.0	-20.5	20.0
IÇK(1Ndryshimi 12 mujor ne %)	0.0	104.4	236.6	31.0	16.0	6.0	17.4	42.0	8.7
Pagat mesatare reale (sektori publik)	NA	-5.8	-45.0	0.0	-2.0	NA	NA	NA	NA
Paraja gjithsej-M3 (fundi i vitit)		110.0	152.7	73.0	39.0	51.0	44.0	32.0	21
Paraja jashte bankave		123.0	81.7	53.6	51.7	52.0	14.0	52.0	- 6.0
	(Ne milione leke)								
Kreditit i brendshem	NA	18 915	31773	80248	94525	85112	126063	180305	209118
Pretendime ndaj Qeverise	NA	7 662	20234	73343	84839	73673	111759	164470	191426
Pretendime ndaj nd. Publike jofinaciare	NA	10765	10164	2444	2485	3093	3414	2898	2830
Pretendime ndaj sektorit privat	NA	488	1375	4462	7201	8347	10890	12955	14862
	(Ne perqindje ndaj PPB)								
Te ardhurat minus shpenzimet	-3.7	-44.0	-21.4	-9.3	-9.0	-6.9	-9.9	-10.1	7.49
Totli i Deficitit	-15.4	-30.7	-21.5	-13.7	-9.0	-8.7	-11.3	-12.2	10.35
Shpenzimet buxhetore	62.0	62.2	46.2	40.4	33.1	32.3	29.8	29.5	30.7

Borxhi i Jashtem	0.0	NA	90.3	41.1	33.1	1.9	5.3	25.3	16.07
Te dhena mbi bilancin e pagesave	(ne milion USD)								
Llogaria Korente	NA	NA	-50.8	14.7	-42.7	-14.6	-107.2	-271.2	-65.0
Transfeta Private	NA	NA	150.0	275.0	374.0	349.0	476.0	236.0	452.3
Transferta Shteterore	NA	NA	374.0	280.0	117.0	129.0	84.0	29.0	82.6
Bilanci Tregtar	- 150.0	-308.0	- 470.0	- 490.0	- 460.0	- 475.0	-678.0	-535.0	-603.7
	(Per jave importi)								
Reserva (perjashtuar arin)	NA	NA	3.3	12.8	17.8	18.4	15.8	25.3	25.0
Tregues te ndryshem									
Popullsia (ne milion leke)	3.3	3.3	3.2	3.2	3.2	3.2	3.2	3.3	3.2
Papunesia (ndrshimi ne %,mesatare vjetore)	0.2	-18.6	-27.8	-7.8	9.3	-1.0	-1.9	-0.8	NA
Norma e papunesise (ne% te forces te punes)	7.6	11.7	30.3	22.3	19.2	13.0	12.4	14.9	NA
PPB (ne milion Leke)	16 816	16 473	49 517	125 334	184 400	229 793	281 000	341 716	480 631
Prodhimi bujqesor ne % te PPB	40.0	44.0	54.0	56.0	56.0	56.0	52.8	56.0	54.4
Prodhimi industrial ne % te PPB	37.0	32.0	17.0	14.0	13.0	11.7	12.5	12.4	11.9
Kursi i Kembimit (Leke per USD, mes. vjetore)	10.0	15.0	75.0	102.0	94.7	92.8	104.5	148.9	150.6
Norma e interesit (huadhenia,12 m. maturimi, fundi i vitit)	1.2	8.12	39.0	30.0	20.0	21.0	28.8	43.0	25.0
	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998		
Depozitat	(ndryshimi vjetor ne %)								
Totali i depozitave	171.8	71.5	3.0	51.9	62.9	17.9	35.6		
Depozita pa afat	33.8	40.9	8.8	55.7	145.5	-55.5	-17.2		
Depozita me afat	249.5	142.1	59.8	50.3	7.6	133.3	63.7		

Foreign exchange deposits	4402.6	43.7	35.3	50.9	68.9	7.1	10.7
Normat e interesit	(fundi i periudhes, vjetore ne %)						
Perqindja e rifinancimit	...	34.0	25.0	20.5	24.0	32.0	22.0
Perqindjet e depozitave -12 m	...	23.0	16.5	13.7	19.1	27.8	16.5
Perqindja e Kredise - 12 m	...	30.0	20.0	21.0	28.8	43.0	25.0
Bono Thesari - 3 m	...	...	10.0	14.7	21.1	35.3	19.9
Bono Thesari - 6 m	...	...	12.1	14.9	22.3	34.5	21.5
Bono Thesari - 12 m	...	...	...	15.1	22.5	35.0	23.0
